



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 240 Akti

Nr. 164 Vendimi

Tiranë, më 19.6.2019

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 4 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Roland Ilia	Anëtar
Valbona Sanxhaktari	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, në datën 17.6.2019, ora 9:00, zhvilloi në Pallatin e Kongreseve seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Margarita Buhali**, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë, e pranishme në seancën dëgjimore.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, dhe “E” të Aneksit të Kushtetutës;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Margarita Buhali është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë. Znj. Buhali është edhe anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe për këtë shkak procesi i rivlerësimit ndaj saj është zhvilluar me përparësi¹. Bazuar në nenin 4, pika 4, dhe në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim, “Komisioni”) ka hedhur shortin në datën 15.1.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4.
2. Me vendimin e trupit gjykues, datë 18.1.2019, është vendosur kryesuese znj. Genta Tafa (Bungo), dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.
3. Është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues që do të kryente procesin e rivlerësimit, e cila ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e trupit gjykues.
4. Janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Gjatë procesit të rivlerësimit është komunikuar me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet adresës elektronike.
5. Në datën 31.5.2019, trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Margarita Buhali, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, ta ftojë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.
6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin e konfirmoi edhe në seancën dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime dhe prova lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit, të cilat u pranuan nga Komisioni.
7. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit, znj. Margarita Buhali në seancë dëgjimore në datën 17.6.2019, ora 9:00, në Pallatin e Kongreseve, Tiranë.

SEANCA DËGJIMORE

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 17.6.2019, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo.
9. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë. Ajo paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
10. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe për rrjedhojë edhe procesin e rivlerësimit për znj. Margarita Buhali në seancën e datës 19.6.2019, në të cilën subjekti ishte e pranishme.

PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

11. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e

¹ Neni 179/11 i Kushtetutës.

Komisionit *hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit*. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indice në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

12. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë këtij institucioni në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, ‘Vetting’”;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me materialin shoqërues;
- ç) Dokumente shkresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) Deklarimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- dh) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si dhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- e) Denoncimet nga publiku.

A. VLERËSIMI I PASURISË

13. Subjekti i deklaramentit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33² të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

14. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “a” të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konkluduar se:

- a) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarament të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

15. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.³

²*“Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaramentet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin, “Për deklaramentimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si dhe “Kodin e Procedurave Administrative”.*

³Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi.”

16. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Margarita Buhali iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

17. Në përfundim të hetimit administrativ, kur Komisioni krijoi bindjen se provat kanë nivelin e provueshmërisë, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht, t'i japë të drejtë subjektit të njihet me rezultatet e këtij hetimi, si dhe me të gjithë dokumentacionin e administruar në dosje.

18. Subjekti i rivlerësimit, znj. Margarita Buhali, në deklaratën e saj të pasurisë për procesin e rivlerësimit, por edhe pas verifikimit administrativ të kryer nga ILDKPKI-ja dhe nga Komisioni, rezulton se ka në pronësi pasuritë si më poshtë.

19. **Apartament me sipërfaqe 81.1m²**, me adresë: Lagjja “****”, pallati ***, Berat, fituar me kontratë shitblerjeje në vitin 2008, në bashëpronësi me bashkëshortin; vlera 2.870.000 lekë.

20. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat ndër vite, fitimet në depozitë e bono thesari në ndër vite në “Raiffeisen Bank” dhe pakësimi i pasurisë bono në vitin 2008.

21. Nga hetimi rezultoi se në datën 23.10.2008 subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë blerë, sipas kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., pasurinë apartament, me sip 81.1 m² ndodhur në Berat. Pasuria është blerë kundrejt çmimit 2.870.000 lekë, vlerë e cila, sipas kontratës, është shlyer plotësisht jashtë zyrës noteriale.

22. Nga verifikimi i llogarive të subjektit pranë “Raiffeisen Bank” ka rezultuar se është tërhequr vlera totale prej 2.580.000 lekësh, përkatësisht në datat:

- 22.10.2008 500.000 lekë;
- 27.10.2008 100.000 lekë;
- 27.11.2008 1.600.000 lekë (me përshkrimin “Margarita Buhali blerje banese”);
- 27.11.2008 380.000 lekë.

23. Transaksionet e kryera nga subjekti (tërheqje) nuk përputhen me datën e likuidimit të çmimit sipas kontratës, për të cilën subjekti ka shpjeguar se e gjithë shuma e blerjes së banesës është paguar para realizimit të kontratës noteriale të shitjes.

24. Lidhur me burimin e të ardhurave subjekti ka sqaruar se në datën 23.10.2008 kur është lidhur kontrata e blerjes së apartamentit, shuma prej 1.500.000 lekësh e investuar në bono thesari nuk ishte maturuar ende (data e maturimit, 22.11.2008). Ndërkohë, për shkak se pronarët e apartamentit donin ta realizonin shitjen pasi i duheshin paratë për nevoja personale, shumën për blerjen e apartamentit e ka siguruar nëpërmjet burimeve të mëposhtme:

- a) shuma 500.000 lekë tërhequr në datën 22.10.2008 nga llogaria e saj;
- b) shuma 220.000 lekë gjendje *cash* nga kursimet familjare nga të ardhurat gjatë vitit;
- c) shuma 1.600.000 lekë marrë hua shtetasës R. H., në datën 22.10.2008 për një muaj, me burim të të ardhurave ndihmë financiare nga Bashkia për viktimat e liqenit të Farkës;
- d) shuma 550.000 lekë marrë nga shtetasja A. K., për dy muaj, me burim të të ardhurave nga aktiviteti biznes të shoqërisë *** me NUIS ***.

25. Subjekti ka sqaruar se huadhënësit janë shlyer tërësisht brenda vitit 2008, nga të ardhurat e fituara në vitin 2008 nga subjekti dhe ish-bashkëshorti i saj dhe paratë nga bonot e thesarit.

26. Lidhur me huan e marrë nga shtetasja R. H., në shumën 1.600.000 lekë, subjekti paraqiti një deklaratë noteriale të datës 25.5.2019 të kësaj shtetaseje, si dhe lëvizje llogarie bankare.

27. Komisioni vlerësoi dokumentacionin provues të sjellë nga subjekti, ku konstatoi se për huan e dhënë nga R. H., ajo ka kryer tërheqje nga llogaria bankare në datën 22.10.2008, në shumën 1.600.000 lekë. Në vijim, në datën 27.11.2008, subjekti e ka kthyer të njëjtën shumë nëpërmjet lëvizjeve bankare në llogarinë e kësaj shtetase, me përshkrimin “për R. H., nga Margarita Buhali për blerje banese”.

28. Lidhur me huan e marrë nga shtetasja A. K., në shumën 550.000 lekë, subjekti ka shpjeguar se ajo ka ushtruar aktivitet privat, e licensuar rregullisht si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, duke bashkëlidhur ekstrakt historik gjeneruar nga faqja zyrtare e QKB-së dhe ka pasur mundësi t’i japë hua këtë shumë për një periudhë të shkurtër kohe, një-dy muaj, deri sa të liroheshin paratë e bllokuara në bono. Subjekti ka shpjeguar se ia ka kthyer huan znj. A.K. brenda vitit, veprime të cilat përputhen me lëvizjet bankare të subjektit. Subjekti ka sjellë edhe një deklaratë noteriale, datë 24.5.2019 të zonjës A. K.

29. Në përfundim të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimi të sjellë dokumentacion provues lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të znj. A. K.

30. Subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të znj. A. K., dhe veprimtarisë së saj tregtare si administratore dhe ortakë e vetme e shoqërisë “****”, sh.p.k., duke bashkëlidhur edhe dokument justifikues “pasqyrat financiare” të vitit 2007 dhe 2008, vite në të cilat fitimi *neto* i shoqërisë ka qenë respektivisht 463.158 lekë dhe 599.825 lekë. Subjekti ka sqaruar se në datat 14 - 15 tetor të vitit 2008, znj. A. K., ka bërë tërheqje nga llogaria e shoqërisë në masa të konsiderueshme, konkretisht 636.485 lekë dhe 1.110.510 lekë, ku për të provuar këtë fakt subjekti ka sjellë në cilësinë e provës “aktin tërheqje nga llogaria e shoqërisë, gjendje 31 dhjetor 2008, printuar nga sistemi i shoqërisë.

31. Komisioni verifikoi provat e sjella nga subjekti me aktet bilanc të vitit 2008 të shoqërisë “****” sh.p.k., gjeneruar nga faqja zyrtare e QKB-së dhe vlerëson se aktet e sjella si provë nga subjekti përputhen me pasqyrat financiare të vitit 2008 dorëzuar nga shoqëria në QKB.

32. Trupi gjykues, pasi vlerësoi dokumentet shkresore, konstaton se znj. A. K., ka pasur një xhiro vjetore të konsiderueshme të deklaruar rregullisht në organet tatimore dhe se ajo ka pasur të ardhura të ligjshme të fituara nga puna e saj dhe si gjendje *cash* në qarkullim në muajin tetor të vitit 2008, nga të cilat mund të jepte hua në vlerën prej 550.000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për një periudhë prej 1, deri në 2 muaj.

33. Komisioni përgatiti analizën financiare, nga ku rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të paguar çmimin e blerjes së apartamentit.

	Përshkrimi	2008
1	PASURI	607.751
	Apartament sip. 81,1 m ² , L. **** Berat	2.870.000
	SHTESA/PAKËSIMI LIKUIDITETE	-2.262.249
2	TË ARDHURA	1.610.576
	Të ardhura subjekti	887.310
	Të ardhura bashkëshorti	557.957
	Të ardhura nga interesat bankare	165.309
3	SHPENZIME	617.084
	Shpenzime jetese	409.860

	Shpenzime udhëtimi sipas TIMS	171.224
	Shpenzime jetese në Berat sipas pyetësorit datë 20.5.2019	36.000
	DIFERENCA (TË ARDHURA – PASURI - SHPENZIME 2-1-3)	385.741

→ Përputhen shpjegimet e subjektit me dokumentacionin e administruar lidhur me këtë pasuri.

34. ZVRPP Berat konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie. Sipas dokumentacionit të ardhur nga ZVRPP⁴ Berat, është konstatuar se me Akt Pjesëtimin nr. *** kol., datë 19.12.2018, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pjesëtuar pasuritë e tyre me vullnet të lirë në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat me nr. ***, datë 22.10.2018, për zgjidhjen e martesës, ku për këtë apartament subjekti ka hequr dorë nga pjesa e saj e bashkëpronësisë prej ½ pjesë, duke i mbetur në pronësi ish-bashkëshortit të saj, z. G. K.

34.1 Sipas kësaj marrëveshjeje është rënë dakord që subjekti të ketë të drejtën e përdorimit pa kundërshtim, si kontribut i ish-bashkëshortit për rritjen dhe edukimin e vajzës së tyre të mitur deri kur të arrijë moshën madhore.

35. Automjet tip “Mercedes Benz E 220D” me targë ***, i vitit 1997, e blerë në vitin 2011, e regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit. Çmimi i blerjes: 1.000 euro dhe vlera e zhdoganimit 54.387 lekë. Pjesa takuese sipas deklaratës “Vetting”: në masën 100 %; sipas DPV-së së vitit 2011: në masën 50 %.

36. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga dhe kompensuar pjesërisht me çmimin e shitjes po në vitin 2011 të makinës së mëparshme me targa ***, blerë në vitin 2006 me të ardhura nga pagat.

37. Nga aktet e ILDKPKI-së ka rezultuar se me kontratën e shitblerjes së automjetit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2011, bashkëshorti i subjektit ka blerë automjetin tip “Mercedes Benz E 220 D” me targë ***, kundrejt çmimit 1.000 euro (kundërvlera në lekë, 138.300), vlerë e cila është likuiduar, sipas kontratës.

38. Në datën 17.12.2011, me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., bashkëshorti i subjektit ka shitur automjetin tip “Mercedes Benz” me targë ***, viti i prodhimit 1987, kundrejt çmimit 1.000 euro.

39. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti ka pasur të burime të ligjshme për blerjen e automjetit.

	Përshkrimi	2011
1	PASURI	260.234
	Autoveturë Benz ***	203.300
	SHTESA/PAKËSIME LIKUIDITETE	56.934
2	TË ARDHURA	2.324.761
	Të ardhura subjekti	1.369.650
	Të ardhura bashkëshorti	779.329
	Të ardhura nga interesat bankare	37.482
	Të ardhura nga shitja e automjetit, blerë në 2006	138.300
3	SHPENZIME	626.775
	Shpenzime jetese	409.860
	Shpenzime udhëtimi sipas TIMS	6.915
	Shpenzime jetese në Berat sipas pyetësorit datë 20.5.2019	10.000
	Shpenzime arredimi sipas pyetësorit datë 20.5.2019	200.000

⁴Shkresë nr. *** prot., datë 25.4.2019, ZVRPP Berat.

40. Bono thesari e depozituar në “Raiffeisen Bank”, dega Berat, gjendja në datën 22.12.2016 në shumën 3.200.000 lekë. Zotëron 100 %.

41. Burimi i krijimit: nga kursimet familjare nga të ardhurat nga pagat ndër vite, fitimet ndër vite me bono thesari, duke i shtuar pasuritë bono nga viti 2011 deri në vlerën aktuale.

42. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti ka depozituar shumën 562.517 lekë bono thesari në “Raiffeisen Bank”, në datën 2.9.2011, e cila e ka origjinën nga llogaria rrjedhëse me nr. ***, në gjendjen 400.119 lekë. Në tabelën më poshtë paraqitet gjendja e likuiditeteve në bono thesari nga viti i krijimit 2011 deri në deklaratën “Vetting”.

Vitet	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Shuma në lekë në bono thesari	562.518	943.689	1.467.609	2.000.000	2.651.949	3.200.000

43. Nga analiza financiare përgatitur nga njësia e shërbimit ligjor rezulton se subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për shtesat e likuiditeteve në bono thesari gjatë këtyre viteve.

44. Likuiditete pranë “Raiffeisen Bank” në vlerën 176.669 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

45. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat për vitet 2016 dhe 2017 dhe fitimi në bono për vitin 2016 i ndarë në tre numra llogarie.

46. Nga verifikimi i llogarive bankare pranë “Raiffeisen Bank” rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

47. Në lidhje me personin e lidhur, shtetasi G. K., përveç pasurive të përbashkëta të deklaruara, të përshkruara më sipër, ka në bashkëpronësi me familjarët e tij edhe pasurinë apartament me sip. 73.25 m², përfituar me trashëgimi ligjore nga i ati V. K⁵. Vlera: 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: ¼ pjesë ose 25 %. Kjo pasuri është blerë nga trashëgimlënësi në datën 23.4.1999.

48. Nga hetimi⁶ ka rezultuar se pasuria me nr. ***, vol. ***, f. ***, ZK *** Fier, e llojit apartament me sip. 73.25 m² është fituar me dëshmi trashëgimie, vendim nr. *** datë 20.04.2006 nga z. V. K., (babai), në bashkëpronësi me të ëmën dhe dy vëllezërit e tij.

49. Hetimi administrativ kryesisht, i kryer nga Komisioni, u shtri edhe më tej nga ai i deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Për këtë është marrë informacion nga organet shtetërore si, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Ujësjetllës Kanalizime, Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, bankave të nivelit të dytë, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ALUIZNI, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministria e Drejtësisë (Regjistri Noterial Shqiptar).

50. Nga hetimi nuk rezultoi ndonjë pasuri e padeklaruar apo e fshehur në pronësi apo në përdorim nga subjekti apo personat e lidhur. Lidhur me pasuritë për persona të tjerë të lidhur të cilat rezultuan gjatë hetimit, trupi gjykues vlerëson se ato nuk i përkasin subjektit të rivlerësimit dhe se janë pasuri ekskluzive të personave të tjerë.

51. Njësia e shërbimit ligjor përgatiti analizën financiare për subjektin e rivlerësimit e cila rezultoi me bilanc pozitiv.

⁵Sipas dëshmisë së trashëgimisë lëshuar me vendimin nr.***, datë 20.4.2006 të Gjykatës Lezhë.

⁶Shih shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2019, ZVRPP Fier.

Analiza financiare për periudhën 2003-2016

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
1 PASURI	0	494.750	791.606	1.151.811	748.710	607.751	361.615	-317.877	10.234	642.115	305.051	694.752	600.910	482.979	6.574.409
Autoveture Benz ***				250.000					-250.000						0
Apartament sip 81,1 m2 L *** Berat						2.870.000									2.870.000
Autoveture Benz ***									203.300						203.300
Apartament sip 73,25 m2 1/4 trashegimi ligjore dt 20/04/2006				250.000											250.000
SHTESA/PAKESIME LIKUIDITETE		494.750	791.606	651.811	748.710	-2.262.249	361.615	-317.877	56.934	642.115	305.051	694.752	600.910	482.979	3.251.109
2 TË ARDHURA	1.143.611	1.309.688	1.533.593	1.804.728	1.442.735	1.610.576	1.460.120	1.715.132	2.186.461	2.078.209	1.693.140	2.212.279	2.398.692	2.229.119	24.818.083
Te ardhura subjekti	619.070	681.960	835.130	862.660	916.205	887.310	894.890	1.149.900	1.369.650	1.340.620	1.029.630	1.308.697	1.491.852	1.230.663	14.618.237
Te ardhura bashkeshorti	524.541	627.728	698.463	583.707	526.530	557.957	565.230	565.232	779.329	681.278	663.510	813.566	837.282	904.989	9.329.342
Te ardhura nga interesat bankare				108.361		165.309			37.482	56.311		90.016	69.558	93.467	620.505
Trashegimi 1/4 apartamentit 73,25 m2				250.000											250.000
3 SHPENZIME	295.928	353.892	406.798	376.671	445.860	445.860	445.860	1.262.180	738.475	568.644	628.114	843.994	896.828	963.094	8.672.198
Meremetim dhe mobilim banese								316.320							316.320
Humbje nga shitja makines									111.700						111.700
Shpenzime shkollimi vajza												40.000	80.000	80.000	200.000
Shpenzime jetese	187.928	281.892	328.671	328.671	409.860	409.860	409.860	409.860	409.860	418.644	423.072	659.994	672.828	705.276	6.056.276
Shpenzime udhetime sipas TIMS			6.127						6.915		28.042			33.818	74.902
Shpenzime jetese ne Berat sipas pyetesorit dt 20/05/2019	108.000	72.000	72.000	48.000	36.000	36.000	36.000	36.000	10.000						454.000
Shpenzime jetese ne Vlore sipas pyetesorit dt 20/05/2019											27.000	144.000	144.000	144.000	459.000
Shpenzime arredimi sipas pyetesorit dt 20/05/2019								500.000	200.000	150.000	150.000				1.000.000
DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 2-1-3)	847.683	461.046	335.189	276.246	248.165	556.965	652.645	770.829	1.437.752	867.450	759.975	673.533	900.954	783.047	9.571.477

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e eficiencës, proporcionalitetit, barazisë së palëve, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ajo ka kryer deklarim që është i saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezultojnë të jetë e ligjshme, nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

Nga hetimi i kryer dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

Subjekti është treguar bashkëpunues gjatë gjithë periudhës së hetimit kryesisht, duke iu përgjigjur pyetësorit të dërguar, si edhe pyetjeve shtesë në një kohë të shpejtë dhe duke dhënë në mënyrë shteruese informacionin e kërkuar.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

52. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit dhe ka dërguar një raport, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Margarita Buhali”*. Ky raport është i deklasifikuar plotësisht.

53. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

54. Komisioni u vu në dijeni të disa fakte të bëra publike në prill të vitit 2018 nëpërmjet emisionit investigativ *“***”*, ndaj bashkëshortit të subjektit, z. G.K., në cilësinë e oficerit të policisë gjyqësore në Prokurorinë Berat, sipas të cilit ai është regjistruar duke u takuar në ambiente jashtë prokurorisë me personin nën hetim dhe duke dhënë sqarime rreth një kallëzimi konkret dhe ka pranuar shumën prej 500 mijë lekë si rryshfet për të mbyllur dosjen penale.

55. Komisioni vlerësoi të hetojë bashkëshortin e subjektit, z. G. K., për përfshirjen e tij në korrupsion aktiv për shkak të detyrës, nisur nga indica konkrete.

56. Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se ndaj shtetasit G.K., Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, në datën 17.4.2018, ka filluar kryesisht procedimin penal nr. *****, për veprën korrupsion aktiv për shkak të detyrës, por më tej dosja dhe fashikulli i plotë i hetimit është transferuar në Prokurorinë e Rrethit Fier, për kompetencë.

57. Bazuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, Prokuroria për Krimet e Rënda heton procedime penale ku subjekt janë prokurorë dhe gjyqtarë, etj. Hetimi i procedimeve penale ku subjekt janë oficerët e policisë gjyqësore, janë në kompetencë lëndore të prokurorive të rretheve gjyqësore, bazuar në nenin 78 të Kodit të Procedurës Penale. Me gjithë ndryshimet e nenit 75 germa “a” të Kodit të Procedurës Penale që kanë hyrë në fuqi nga data 1.8.2017, sipas vendimit njëhësues të Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 4.4.2018, hetimi i këtyre çështjeve deri në krijimin e SPAK do të jenë në kompetencën e prokurorive të rretheve gjyqësore.

58. Shtetasi G.K., ka ushtruar funksionet e Oficerit të Policisë Gjyqësore në seksionin e policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat dhe, bazuar në nenin 78 të Kodit të Procedurës Penale, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier është prokuroria e rrethit më të afërt me prokurorinë ku ky shtetas ushtronte funksionet në momentin e regjistrimit të procedimit.

59. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka informuar Komisionin se procedimin penal ndaj këtij shtetasi është aktualisht nën hetim.

60. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka sqaruar se mbi materialin e ardhur për kompetencë nga Prokuroria për Krimet e Rënda, në datën 3.1.2019 është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier procedimi penal nr. ***, për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal - *“Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”*, në ngarkim të shtetasi G. V. K. Çështja aktualisht është ende në fazë hetimi.

61. Nga dokumentacioni i administruar është konstatuar gjithashtu se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat ka filluar kryesisht procedura për procedim disiplinor për z. G.K., dhe se Komisioni i procedimit disiplinor ka konkluduar me dhënien e masës disiplinore të *“Pezullimit nga detyra për 6 muaj”*, për Oficerin e Policisë Gjyqësore, G.K. Në përfundim Komisioni disiplinor i ka propozuar Prokurorit të Përgjithshëm materialin për marrjen e vendimit përfundimtar.

62. Komisioni është informuar nga Prokuroria e Përgjithshme se me vendimin nr. ***, datë 26.10.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm është vendosur *“Pezullimi nga detyra i Oficerit të Policisë Gjyqësore G.K.”*.

Në materialet shoqëruese të ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme është konstatuar se në kushtet kur ekzistojnë dy procese paralele ndaj OPGJ-së, procedimi disiplinor, i cili është administrativ dhe procedimi penal, të cilat mbështeten në të dhënat e marra nga i njëjti burim provash, referuar edhe qëndrimit të unifikuar të gjykatës, e cila në raste të tilla pezullon gjykimin e çështjeve administrative deri në zgjidhjen e çështjes penale me vendim të formës së prerë, sipas rastit konkret, duhet të pezullohet procedimi disiplinor deri në përfundimin e procedimit penal me vendim të formës së prerë.

63. Nga hetimi është vënë re se subjekti i rivlerësimit ka bërë kërkesë për t’u divorcuar nga bashkëshorti i saj në datën 6.9.2018 dhe se në datën 22.10.2018 janë divorcuar. Po ashtu, ata kanë bërë edhe ndarjen e pasurisë së tyre të përbashkët. Në dokumentin e divorcit (referuar vendimit të gjykatës) thuhet se subjekti ka pasur edhe një përpjekje në vitin 2010 për t’u divorcuar, e cila ka përfunduar me pajtim.

64. Gjatë hetimit Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit nëse kishte bashkëjetesë me ish-bashkëshortin, nisur edhe nga fakti se ajo dhe vajza jetonin në shtëpinë e ish-bashkëshortit pas ndarjes së pasurisë.

65. Për këtë çështje subjekti ka shpjeguar:

*“Deklaroj se nuk kam bashkëjetesë me të as në kuptim të nenit 163 të Kodit të Familjes dhe as në kuptim të faktit. Ne komunikojme vetëm për nevoja të vajzës. Sipas informacionit që kam, ai jeton në Fier në apartamentin e prindërve të tij në lagjen “****”, rruga “****.”*

...

“Ajo që dua të sqaroj është se ndarja e pasurisë është realizuar në mënyrën e parashikuar në aktmarrëveshje vetëm për një qëllim madhor, që është rritja e edukimi sa i mirë i fëmijës.”

66. Në përfundim të hetimit rezultoi se:

- Shtetasi G. K., është një kontakt i papërshtatshëm në kuptim të nenit 3, pika 15, e ligjit nr. 84/2016, pasi rezultoi se ndaj tij ka filluar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, në datën 17.4.2018, procedimi penal nr. ***, për veprën korrupsion aktiv për shkak të detyrës.
- Kontakti i papërshtatshëm ka lindur pas plotësimit të deklaratës *“Vetting”* nga subjekti i rivlerësimit.

- Në lidhje me kontaktin e papërshtatshëm ekzistojnë rrethana lehtësuese që duhen marrë në konsideratë në vlerësim, në përputhje me nenin 38, pika 5, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.

67. Në lidhje me këtë rezultat hetimi subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në asnjë rast nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme dhe se nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi si “person me kontakte të papërshtatshme” për veprime të personave të tjerë qoftë ky edhe ish-bashkëshorti, për aq kohë sa nuk është përfshirë dhe as ka qenë në dijeni të këtyre situatave prej të cilave është e distancuar tërësisht. Znj. Buhali i vuri në dispozicion Komisionit edhe vendimin nr. ***, datë 24.1.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, lidhur me kërkesën e saj për divorc në vitin 2010, çështje e cila u pushua për shkak të pajtimit.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacione nga organet ligjzbatuese, dokumente të administruara nga organet shtetërore, duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

- Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.

- Megjithëse gjatë hetimit rezultoi se ish-bashkëshorti i subjektit është një kontakt i papërshtatshëm në kuptim të nenit 3, pika 15, e ligjit nr. 84/2016, ai ka lindur pas plotësimit të deklaratës “Vetting”, dhe se gjatë hetimit u konstatua se ekzistojnë rrethana lehtësuese që duhen marrë në konsideratë në vlerësim, në përputhje me nenin 38, pika 5, germa “c”, e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit ka qenë i hapur dhe i besueshëm në deklarime dhe është distancuar prej tij.

- Për subjektin e rivlerësimit nuk pati indice apo prova që të jetë e përfshirë në veprime korruptive, apo e vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Margarita Buhali ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Subjekti është treguar bashkëpunues gjatë gjithë periudhës së hetimit kryesisht, duke dhënë shpjegime në një kohë të shpejtë dhe në mënyrë të besueshme për informacionin e kërkuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

68. Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka dorëzuar raportin profesional për subjektin e rivlerësimit.

69. Nga vlerësimi i tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short, janë vënë re këto gjetje lidhur me kriteret e vlerësimit, sipas ligjit nr. 96/2016.

70. Subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Është njohëse e mirë e të drejtës materiale penale dhe civile, si dhe njeh dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit. Përdor referencë në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, në funksion të arsytimit të vendimit. Subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të kryer shpejt procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Ajo është e qartë për rolin e Gjykatës së Apelit dhe kryen veprimet e nevojshme procedurale për zgjidhjen e pretendimeve të paraqitura në apelin e palëve.

71. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit për gjyqtaren Margarita Buhali janë paraqitur 9 ankesa (3 në vitin 2014, 3 në vitin 2015, dhe 3 në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së, të cilat janë arkivuar, pasi pretendimet janë të pabazuara.

72. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Margarita Buhali, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional

Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, dhe konsiderohet “i aftë”.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

D. DENONCIMET E PUBLIKUT

73. Denoncim nr. *** prot., datë 24.4.2019 nga Av. S. N., kundrejt gjashtë subjekteve që kanë gjykuar në trupa gjyquese, përkatësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat (3) dhe në Gjykatën e Apelit Vlorë (3), ku subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i trupës. Denoncimi trajton pretendimin për paligjshmëri në vendimmarrje duke favorizuar njërin palë për një çështje civile me palë B. Z., kundër P. B., dhe ndërhyrës kryesor shoqëria “****” sh.p.k., me objekt: detyrim për kthim shume. Në këtë denoncim janë trajtuar disa pretendime për shkelje të kryera nga këto dy trupa gjyquese, por konkretisht për trupin gjykues ku subjekti ka qenë anëtar, pretendohet cenim të të drejtave të palës së paditur lidhur me riçeljen tërësore të hetimit dhe caktimin e një eksperti (të drejta këto të palëve në një proces gjyqësor).

74. Nisur nga këto indice, Komisioni verifikoi këtë ankesë duke i kërkuar gjykatës kompetente të njihet me dosjen, në vlerësim të të cilit rezultoi se me vendimin nr. ***, datë 18.4.2019, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 27.3.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Gjyqtarja Buhali në këtë vendim ka mbajtur qëndrim ndryshe nga anëtarët e tjerë të trupës (mendim pakice) duke kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe dërgimin e çështjes për rigjykim me një tjetër trupë gjyquese.

75. Subjekti ka sqaruar në shpjegimet e saj se avokati ka bërë këtë denoncim para se të administronte kopjen e vendimit të marrë për çështjen. Komisioni vlerëson se ky denoncim nuk qëndron për subjektin e rivlerësimit.

76. Denoncim me nr. *** prot., datë 20.12.2018 i shtetasit H. G., drejtuar tre subjekteve. Subjekti i rivlerësimit në këtë denoncim është kryetare e trupës së Gjykatës së Apelit Vlorë. Shtetasi ka denoncuar vendimin e padrejtë të pambështetur në prova dhe fakte të marrë nga një subjekt tjetër pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, lidhur me një çështje pronësie për të cilën shtetasi, bashkë me disa persona, kanë investuar gjykatat.

77. Denoncim me nr. *** prot., datë 13.12.2018 i shtetasit F. B., drejtuar tre subjekteve, me të njëjtin objekt dhe fakte trajtuar në denoncimin e mëparshëm. Shtetasi ka denoncuar vendimin e padrejtë të pambështetur në prova dhe fakte të marrë nga një subjekt tjetër pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë lidhur me një çështje pronësie për të cilën ky shtetas, bashkë me disa persona të tjerë të interesuar, përfshirë edhe denoncuesin më lart, kanë investuar gjykatat.

78. Lidhur me këto dy denoncime të shtetasve H. G., dhe F. B., subjekti ka shpjeguar se lidhen me vendimin nr. ***, datë 6.1.2018, marrë nga Gjykata e Apelit Vlorë, ku ajo ka qenë relatore dhe se pretendimet e ankuesve kanë të bëjnë me thelbin e zgjidhjes së çështjes, që në fakt është objekt i rekursit në Gjykatën e Lartë.

Subjekti ka sqaruar se në vendim i është dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve ankimese, si për sa i përket pretendimeve për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, faktit nëse pasuria është apo jo shtetërore, legjitimitetit të tyre për objektin e padisë, pavlefshmërinë

e kontratës, etj., po ashtu iu është garantuar e drejta të paraqesin pretendime e prova të reja në gjykimin në apel, megjithëse gjykata e shkallës së parë kishte kryer një hetim të detajuar mbi çështjen duke marrë edhe prova me ekspert.

79. Denoncimet kanë të bëjnë me zgjidhjen e dhënë për themelin e çështjes nga gjykata dhe është bërë nga palët gjyqumbëse dhe bie ndesh me vendimet nr. 11/2004 dhe nr. 11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

80. Denoncim i shtetasit Gj. Sh., nr. *** prot., datë 13.3.2018 ndaj një trupi gjykues i deleguar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, ku subjekti ka qenë anëtar. Nga shqyrtimi i fakteve dhe dokumentacionit bashkëlidhur, duket se denoncuesi ka trajtuar çështje të themelit të cilat i janë nënshtruar gjykimin pranë dy shkallëve të gjyqësorit.

81. Subjekti ka sqaruar se është caktuar në këtë çështje me komandim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për shkak të ezaurimit të pjesës tjetër të trupës gjyqësore të Gjykatës së Apelit Shkodër. Për sa i përket pretendimeve të denoncuesit për vendim të padrejtë, këto pretendime nuk qëndrojnë. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar në mënyrë të detajuar se për këtë çështje ka pasur shtyrje për shkaqe ligjore që nuk vareshin nga ajo dhe që lidheshin me mungesën e anëtares së trupit gjykues, gjyqtaren B.U., e provuar me raport mjekësor. Në vijim, gjykimi i çështjes ka përfunduar me marrjen e vendimit menjëherë në seancën pasardhëse gjyqësore.

82. Denoncim i përsëritur nr. *** prot., datë 4.1.2018, nga shtetasi Gj. Sh., me të njëjtin objekt, i cili është trajtuar më lart.

83. Denoncim i shtetasit G. T., regjistruar me nr. *** prot., datë 20.3.2018 kundrejt 50 subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, me objekt: shkelje të ligjit, korrupsion. Ky denoncim trajton për subjektin e rivlerësimit (në cilësinë e relatores) se mban të bllokuar një proces me objekt “Rivendosja e kërkesit në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit nr. ***, datë 24.5.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”, i cili nuk është shqyrtuar ende.

84. Subjekti ka sqaruar se pretendimi i shtetasit G. T., nuk ka për objekt rivendosjen në afat të ankimit ndaj vendimit nr. ***, datë 24.5.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, por çështjen penale me nr. *** regjistri, datë 7.12.2017, që i përket palës kërkuese ***, me përfaqësues G. T., kundër të akuzuarit V. F., me objekt “ndjekje penale për të akuzuarin për veprat penale”, të parashikuar nga neni 119/2, 120/2, 305 dhe 143 të Kodit Penal. Me vendimin nr. ***, datë 24.5.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur pushimin e çështjes penale ndaj të akuzuarit V. F., për veprat penale të shpifjes dhe të fyerjes. Kërkuesi, ***, me përfaqësues shtetasin G. T., ka bërë kërkesë për rivendosjen në afat të ankimit kundër këtij vendimi dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin e saj nr. ***, datë 6.11.2017 ka pranuar kërkesën e kërkesit duke e rivendosur në afat për të bërë ankim kundër vendimit nr. ***, datë 24.5.2017. Me marrjen e këtij vendimi kërkuesi, *** ka paraqitur ankimin, i cili megjithëse në objekt citohet rivendosje në afat të çështjes penale të pushuar me vendimin nr. ***, datë 24.5.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në fakt është ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 24.5.2017 për pushimin e çështjes penale dhe jo ankim ndaj vendimit të rivendosjes në afat. Nga sa më sipër, rezulton se çështja në gjykim në Gjykatën e Apelit është ajo me nr. *** regjistri, datë 7.12.2017, që i përket kërkesit ***, me përfaqësues G. T., kundër të akuzuarit V. F., me objekt “ndjekje penale për të akuzuarin për veprat penale”, të parashikuar nga neni 119/2, 120/2, 305 dhe 143 të Kodit Penal.

85. Lidhur me pretendimin e zvarritjes së gjykimin, subjekti ka sqaruar në mënyrë të detajuar se, bazuar në ligji nr. 38/2017, “Për ndryshimet në kodin e procedurës penale të Republikës së Shqipërisë”, neni 399/2 afati i gjykimin penal për krimet në Gjykatën e Apelit është 1 vit, ndërsa për kundravajtjet është 6 muaj. Çështja është regjistruar për gjykim në Gjykatën e Apelit në datën 7.12.2017, ku është caktuar me short për gjykimin e kësaj çështjeje në datën 22.2.2018 pasi gjyqtari i mëparshëm S. D., ka dhënë dorëheqjen. Fizikisht, dosja është dorëzuar nga sekretarja gjyqësore në datën 26.2.2018. Subjekti ka sqaruar se edhe pse çështjet e muajit mars ishin planifikuar më parë dhe në muajin prill, për rreth një javë, në datat 16-19, subjekti ka

qenë jashtë shtetit, kjo çështje është planifikuar për të dalë për gjykim në datën 26.4.2018, duke u caktuar për gjykim data 17.5.2018. Fletëthirrjet i përkasin datës së përpilimit 27.4.2018. Pra, pavarësisht ngarkesës me çështje të mbartura ndër vite për shkak të ngarkesës së punës të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila përbën një fakt të njohur edhe në institucionet e drejtësisë, ka caktuar për shqyrtim këtë çështje brenda afatit ligjor 6-mujor të parashikuar nga ligji. Subjekti, gjithashtu sqaron se në datën 17.5.2018, kur do të gjykohej kjo çështje, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e dy gjyqtarëve të trupit gjykues, konkretisht për përjashtimin e subjektit dhe gjyqtarit anëtar S. N. Me ardhjen në dijeni të kësaj kërkesë për përjashtim, gjykata ndërpreu gjykimin bazuar në ligj dhe i dha mundësi kërkuetit ta paraqiste kërkesën me shkrim. Për këtë shkak gjykata caktoi një seancë tjetër për gjykimin e çështjes që ishte data 30.5.2018. Ndërkohë, subjekti ka sqaruar se pasi u njoh me vendimin nr. ***, datë 10.6.2015, ka bërë kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, nisur kjo nga fakti se kërkesa për heqje dorë prevalon në shqyrtim mbi kërkesën e përjashtimit sipas nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale, dhe për të shmangur çdo lloj paragjykimi për pjesëmarrjen në gjykim, për të cilën, me vendimin e datës 18.5.2018, është pranuar kërkesa për heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje. Në vijim, po në datën 18.5.2018 çështja ka kaluar për shortim, ku si gjyqtar relator është caktuar për gjykim gjyqtari P. A. Nga verifikimi në RIV kjo çështje vazhdon të jetë akoma në gjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë. Subjekti ka bashkëlidhur aktin RIV ku rezultojnë të pasqyruara veprimet e kryera lidhur me këtë çështje, kërkesa për heqje dorë e bërë nga gjyqtarët dhe vendimi i kryetares së gjykatës për miratimin e kërkesës miratim dorëheqje.

86. Nga verifikimet rezultoi se subjekti ka respektuar me rigorozitet të gjitha detyrimet ligjore për planifikimin e kësaj çështjeje sipas afateve ligjore të parashikuara dhe nuk është bërë pengesë në asnjë moment për gjykimin e saj.

87. Denoncim i shtetasit F. A., regjistruar me nr. *** prot., datë 27.6.2018, drejtuar pesë subjekteve, përfshirë edhe subjektin si anëtare e trupës gjykuese në Gjykatën e Apelit Vlorë, me objekt “vendimmarrje të padrejtë dhe të pabazuar në prova dhe ligj”.

88. Për verifikimin e këtij denoncimi, Komisioni ka kërkuar dosjen e plotë në Gjykatën e Apelit, ku nga verifikimi u vu re se gjyqtarja Buhali në këtë vendim ka mbajtur qëndrim ndryshe nga anëtarët e tjerë të trupës (mendim pakice) duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 10.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pranimin e padisë të paditësit dhe të ndërhyrësit kryesor, duke u detyruar të njohin bashkëpronar paditësit mbi pasurinë e tij. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se ky denoncim nuk qëndron për subjektin e rivlerësimit.

89. Denoncim i shtetasit A.B., regjistruar me nr. *** prot., datë 26.12.2017 drejtuar disa subjekteve.

90. Ky denoncim është i paqartë dhe nuk përmban elementët e domosdoshëm që lidhen me objektin e tij, përshkrimin e shkeljes ligjore dhe pasojat e ardhura, sipas nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

91. Subjekti ka shpjeguar lidhur me këtë denoncim se ka qenë anëtare e trupës që ka dhënë vendimin nr. ***, datë 11.2.2015 ndaj të pandehurit K. N., i akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 79/dh dhe 22 i Kodit Penal dhe nenet 278/2 dhe 278/4 të Kodit Penal. Me këtë vendim është vendosur të lihet në fuqi vendimi nr. ***, datë 10.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit është bërë recurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. ***, datë 12.5.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit. Subjekti ka sqaruar se në këtë çështje ka qenë pjesërisht në pakicë lidhur me uljen e masës së dënimit në raport me atë të caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, për veprën penale të parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal. Subjekti ka bashkëlidhur edhe dokumentacionin provues.

92. Në përfundim rezulton se pretendimet e ngritura në denoncim për vendimin nuk qëndrojnë pasi vendimi i gjykatës së rrethit dhe i Gjykatës së Apelit është gjetur i drejtë nga të gjitha

- gjykatat duke u zgjidhur çështja me një vendim, që në kuptim të vendimit unifikues nr. 2/2014, përbën gjë të gjykuar, i cili është i padiskutueshëm për fuqinë e tij detyruese përfundimtare.
93. Denoncim i shtetas D. K., regjistruar me nr. *** prot., datë 2.3.2018 drejtuar ndaj katër subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, me objekt: vendimmarrje e padrejtë, korrupsion.
94. Nga vlerësimi i denoncimit nuk gjendet asnjë relativ faktesh ose vendimesh për të cilat ngre pretendimet ndaj subjektit. Pretendimet për vendime të padrejta dhe korrupsion janë të pambështetura dhe deklarative.
95. Denoncim i shtetasit B. S., regjistruar me nr. *** prot., datë 27.12.2018 kundrejt pesë subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Denoncuesi ankohet se trupa gjyqësore e apelit, përfshirë edhe subjektin, nuk e kanë thirrur në gjykim për t'u dëgjuar lidhur me pretendimet paraqitur në ankimin e tij kundër vendimit të gjykatës së rrethit për pushimin e procedimit penal, nisur mbi bazën e kallëzimit të këtij shtetasi.
96. Komisioni verifikoi këto pretendime dhe konstatoi se me ndryshimet e nenit 329/7 dhe 329/a, 329/a/6 të Kodit të Procedurës Penale, miratuar me ligjin nr. 35/2017, ankimi kundër vendimit të pushimit të akuzës, ose çështjes, shqyrtohet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve. Gjykata ka vijuar shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, sikurse e detyron ligji, dhe ka gjetur të drejtë vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Për rrjedhojë, nuk u verejtën indice lidhur me kriteret e vlerësimit ndaj subjektit.
97. Denoncim i shtetasit A. Sh., regjistruar me nr. *** prot., datë 15.5.2019 drejtuar tre subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, anëtarë të trupës gjyqësore në Gjykatën e Apelit Vlorë me objekt: parandalimin e një vendimi të paragjykuar, për një çështje civile në shqyrtim.
98. Subjekti ka sqaruar se, sipas denoncimit, çështja është ende në gjykim me kryesues gjyqtarin S. N., dhe për këtë arsye nuk mund të japë asnjë shpjegim tjetër për këtë çështje.
99. Denoncim i shtetasit Th. P., me nr. *** prot., datë 8.1.2018 ndaj 12 subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, me objekt: korrupsion, zvarritje të procesit, shkelje ligjore për çështje pronësie.
100. Nga përmbajtja e këtij denoncimi vihen re shprehje të karakterit të përgjithshëm pa asnjë të dhënë konkrete. Kërkuar, megjithëse ngre pretendime për parregullsi të procesit, nuk paraqet asnjë provë ose rrethanë se ku qëndron parregullsia dhe as vendimin.
101. Denoncim i shtetasit V. M., nr. *** prot., datë 20.12.2017 kundrejt gjashtë subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, me objekt: vendimmarrje të padrejta në kundërshtim me ligjin për çështje civile, njohje trashëgimtar ligjor dhe detyrim regjistrim pasurie në bashkëpronësi.
102. Subjekti ka sqaruar se për shtetasin V. M., ka dhënë vendimin nr. *** , datë 11.11.2015, së bashku me gjyqtarët I. B., dhe P. A. Faktet e pretenduara nga denoncuesi se nuk është thirrur në gjykim në apel nuk qëndrojnë, pasi ai rezultoi se ka qenë i përfaqësuar në gjykim me avokat të zgjedhur. Gjykata ka dhënë të gjitha arsyet në vendim duke zbatuar vendimin unifikues nr. 24, datë 13.3.2002 të Gjykatës së Lartë.
103. Pretendimet e denoncuesit kundër vendimit kanë të bëjnë me themelin e vendimmarrjes dhe, si të tilla, ato janë objekt i gjykatave më të larta nëpërmjet rekursit, në përputhje me vendimin nr. 11/2004 të Gjykatës Kushtetuese.
104. Denoncim i shtetasve A., dhe M. J., regjistruar me nr. *** prot., datë 13.7.2018, drejtuar katër subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, me objekt “monitorimin e proceseve gjyqësore të gjykuara në Gjykatën e Apelit Vlorë (ku subjekti referohet si kryetare trupe), lidhur me vendimmarrjet e bashkimit të çështjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat”.

105. Nga vlerësimi i fakteve të trajtuara në denoncim, duket se nuk ka indice për vijimin e hetimeve të mëtejshme, në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Vendimet e ndërmjetme që jep gjykata, sikurse edhe ai i bashkimit, u janë bashkëngjitur vendimit përfundimtar.

106. Denoncim nga studio ligjore ***, regjistruar me nr. *** prot., datë 25.7.2018 me objekt “ankim ndaj tre subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, anëtarë të trupës gjyquese në Gjykatën e Apelit Vlorë për vendimmarrje të padrejtë në një çështje civile, dëmshpërblimi dëmi real, pasuror dhe jopasuror”.

107. Subjekti ka sqaruar se vendimi nuk është arsyetuar nga ana e saj pasi ka qenë anëtare në këtë trupë gjyquese. Ajo ka sqaruar se me vendimin nr. ***, datë 20.6.2018, me kryesues gjyqtarin S. D., anëtar S. N., dhe subjektin e rivlerësimit, është vendosur prishja e vendimit nr. ***, datë 10.1.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimi i çështjes për rigjykim. Subjekti ka arsyetuar mbi shkaqet e prishjes së vendimit për pavlefshmëri të padisë, por edhe për thirrjen e personit të tretë, i cili ishte personi shkakhtar i aksidentit duke mbartur pasojat sipas nenit 192 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me përfundimin e gjykimit, pasi ndaj tij mund të kërkohej më regres pagimi i dëmshpërblimit nga shoqëria siguruese. Ndërkohë, rezultoi se po ky shtetas ka përfaqësuar interesat e të miturës M. M., në prokurën, që kërkon dëmshpërblimin për vdekjen e nënës së saj. Është konstatuar se padia nuk është nënshkruar nga paditësja, e cila në kohën e ngritjes së padisë ishte mbi 14 vjeç, ndërsa prokura ishte lëshuar kur ajo ishte nën 14 vjeç, vetëm nga përfaqësuesi i saj ligjor. Me mbushjen e moshës 14 vjeç i mituri fiton zotësi të pjesshme për të vepruar dhe ai i kryen vetë veprimet me pëlqimin e kujdestarit. Në përfundim ajo ka sqaruar se Gjykata e Apelit ka vepruar në përputhje me bindjen e saj të brendshme të krijuar nga provat dhe ligji.

108. Nga vlerësimi i fakteve të trajtuara në denoncim u vlerësua se ky denoncim nuk qëndron.

109. Denoncim nga shtetasi M. D., regjistruar me nr. *** prot., datë 2.2.2018, drejtuar katër subjekteve, ku përmendet edhe subjekti i rivlerësimit për marrjen e vendimeve të padrejta për çështje pronësie. Denoncuesi ka bashkëlidhur edhe dokumentacionin për të provuar faktet.

110. Nga vlerësimi i vendimeve të gjykatës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka shqyrtuar dhe as ka marrë vendim lidhur me çështjen.

111. Denoncim i shtetases L. Z., regjistruar me nr. *** prot., datë 12.4.2018 drejtuar gjashtë subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, anëtare e trupës gjyquese në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila është ankuar për shkelje të kryera nga subjektet (prokurorë dhe gjyqtarë) në dhënien e vendimeve, ku subjekti, bashkë me anëtarët e tjerë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, lidhur me dënimin e djalit të saj me 25 vite burgim për veprat penale “Vrasje me dashje e kryer në rrethana të cilësuar dhe prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”.

112. Denoncim i përsëritur i shtetases L. Z., regjistruar me nr. *** prot., datë 23.1.2019, me të njëjtin objekt.

113. Nga vlerësimi i fakteve të trajtuara në denoncim nuk ka indice për vijimin e hetimeve të mëtejshme nga Komisioni, në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

114. Subjekti ka sqaruar se ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të dënimit të djalit të ankueses, vendim i cili ka mbetur në fuqi edhe në Gjykatë të Lartë. Në vendim janë sqaruar të gjitha shkaqet e ankimit.

115. Denoncim i shtetasit K. N., regjistruar me nr. *** prot., datë 5.4.2018 drejtuar tre subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit si trupë gjyquese, me objekt “vendimmarrje të padrejta dhe abuzive”.

116. Subjekti ka sqaruar se Gjykata e Apelit ka marrë vendimin nr. ***, datë 8.7.2014, në të cilin ajo ka qenë anëtare, duke u lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë nr. ***, datë 29.12.2006. Në vendim janë sqaruar shkaqet që kanë çuar gjykatën në marrjen e

këtij vendimi, duke u vlerësuar me objektivitet provat e marra në përputhje me ligjin. Subjekti ka bashkëlidhur edhe kopje të vendimit.

117. Nga vlerësimi i dokumenteve rezulton se pretendimet e denoncuesit janë vetëm deklarative dhe të pabazuara.

118. Denoncim i shtetasit K. L., regjistruar me nr. *** prot., datë 26.11.2018, drejtuar disa subjekteve gjyqarë dhe prokurorë në Vlorë, nga ku përmendet edhe subjekti i rivlerësimit, me objekt “vendimmarrje të padrejta nga këto subjekte të korrupsuara, të cilët kanë pushuar procedimin penal ndaj shtetasit A. H.”, të nisur mbi bazën e kallëzimit të denoncuesit.

119. Subjekti ka sqaruar se për sa i përket pretendimeve të denoncuesit për vendimin nr. ***, datë 6.12.2017, me gjyqtar relator S. N., dhe subjektin në cilësinë e anëtares, ka sqaruar se në vendim, në mënyrë të detajuar, kanë gjetur përgjigje të gjitha pretendimet që ai ka ngritur kundër vendimit të prokurorisë datë 19.6.2015 për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015 ndaj shtetasve A. H., etj., duke bashkëlidhur edhe kopje të vendimit të marrë.

120. Subjekti ka dhënë detaje dhe ka bashkëlidhur edhe vendimin nr. ***, datë 17.11.2014 me kërkues, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, kundër të pandehurit K. L., i akuzuar për kryerjen e veprës penale të fyerjes së gjyqtarit të parashikuar nga neni 318 i Kodit Penal ku është vendosur prishje e vendimit nr. ***, datë 30.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe pushimin e çështjes penale në bazë të ligjit nr. 22/2014, “Mbi amnistinë”. Gjatë gjykimit të çështjes në apel kishte hyrë në fuqi ligji nr. 22/2014 që amnistonte ndjekjen penale të veprës për të cilën ishte proceduar i pandehuri. Prokurori ka kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe pushimin e çështjes penale. Vetë i pandehuri është shprehur dakord me prokurorin.

121. Nga vlerësimi i fakteve dhe dokumentacionit të administruar, u vlerësua se ky denoncim nuk qëndron.

122. Denoncimi nr. *** prot., datë 30.4.2019 (ardhur pranë ONM-së) nga B. H., drejtuar dy trupave gjyqese në Gjykatën e Apelit Vlorë, për vendimmarrje të padrejtë lidhur me një konflikt me ZVRPP-në Vlorë për regjistrimin e një pasurie në Vlorë trashëguar nga babai i tij.

123. Subjekti ka sqaruar se në vendimin e marrë nr. ***, datë 2.6.2015 nga gjykata e apelit, ka qenë anëtar, ku është prishur vendimi i gjykatës së shkallës së parë për shkelje procedurale në drejtim të ndërtimit të rregullt të ndërëgjyqësisë për thirrjen si palë të shoqërive ndërtuese që kishin investuar në truallin ku ngrinin pretendime pronësie palët dhe çështja është kthyer për rishqyrtim duke u prezantuar në vendim të gjitha arsyet se përse gjykata e apelit ka arritur në këtë përfundim. Kundër këtij vendimi kërkuesi, pavarësisht pretendimeve që ngre, nuk ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë duke vijuar rregullisht gjykimin në shkallë të parë. Subjekti ka bashkëlidhur kopje të vendimit.

124. Nga vlerësimi fakteve të trajtuara në këtë denoncim konstatohet se denoncuesi nuk ngre pretendime ndaj subjektit si gjyqtare dhe se nuk duket të ketë indice për hetime të mëtejshme ndaj subjektit të rivlerësimit.

125. Denoncim nr. *** prot., datë 30.5.2019 nga shtetasi M. Th. K., drejtuar 16 subjekteve (prokurorë dhe gjyqtarë), midis tyre referohet edhe subjekti i rivlerësimit, me objekt “ankimi kundër vendimeve të marra lidhur me çështjet gjyqësore dhe procedimet penale të tij”.

126. Subjekti ka sqaruar se ka dhënë vetëm një vendim ndaj këtij subjekti me nr. ***, datë 25.3.2009, ku i ka njohur pjesërisht të drejtën e dëmshpërblimit ndaj të paditurve P. B., etj. Për këtë ka dërguar kopje të vendimit, ku rezultojnë se janë analizuar gjithë pretendimet e palëve.

127. Pas vlerësimit të fakteve dhe dokumentacionit bashkëlidhur denoncimit nuk u vërejtën indice për subjektin e rivlerësimit, për të vijuar me hetime të mëtejshme.

128. Në përfundim, trupi gjyqes vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, të cilat i gjen në përputhje me dokumentacionin e administruar. Në përgjithësi, denoncuesit kanë

qenë në cilësinë e gjyqumbësve kundër vendimeve të gjykatës dhe se, bazuar në vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 11/2004 dhe nr. 11, datë 2.4.2008, vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e tyre, garanci të cilën e përforcoi ndryshimi aktual i nenit 137 i Kushtetutës, me ligjin nr. 76/2016.

Në përfundim, nga vlerësimi i denoncimeve, trupi gjykues konstaton se nuk u gjetën fakte të besueshme të cilat mund të cenonin punën e subjektit të rivlerësimit në kuptim të nenit 45, pika 4, të ligjit nr. 84/2016. Denoncimet e analizuar nuk ngritën dyshime të arsyeshme për veprime korruptive të kryera nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpunim me persona të tjerë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë të vlerësimit të aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Margarita Buhali.
2. Ky vendim i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Komisionerit Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 19.6.2019

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUES
Genta Tafa (Bungo)
nënshkrimi

ANËTAR
Roland Ilia
nënshkrimi

RELATOR
Valbona Sanxhaktari
nënshkrimi

Sekretare gjyqësore
Fiorela Mandro
nënshkrimi